



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 95 Prot

Tiranë, më 12.06 2009

VENDIM Nr. 5 dt. 04.06.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 04.06.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

I. Të miratojë projektet e restaurimit të investuara nga buxheti i shtetit:

1. **Miratohet:** Preventi pjesor i Manastirit të Mesopotamit, projekti miratuar me vendim nr. 8, dt 08.04.2008). (vijim i punimeve në Manastir)
2. **Miratohet:** Restaurimi dhe konsolidimi i pikturës murale në kishën e Sveti Spas, Kërçisht, Peshkopi.
3. **Miratohet:** Konservimi dhe restaurimi i pikturës murale në kishën e Shën Mërisë, Apolloni.
4. **Miratohet:** Projekti i ndriçimit dekorativ dhe profesional i ansamblit të lagjes Mangalem, Berat.
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi mure-porta-fasada, itinerari Goricë, Berat.
6. **Miratohet:** Projekti për ringritjen e murit të shembur në afërsi të akropolit dhe menaxhimin e vegjetacionit përreth tij, Butrint.

II. Kërkesa për oponencë nga institucione të ndryshme:

1. **Miratohet** kërkesa për miratimin e “Studimit Urbanistik përgjatë rrugës së Rinasit”. **me vërejtje:** Në genplanin e përgjithshëm të vendosen Koordinatat,

2. **Miratohet:** Studim urbanistik pjesor dhe leje sheshi për objektin “Kompleks Sportiv”, në komunën Bubq, Qarku Durrës, **me vërejtjen: Kur të hapen themelet e Kompleksit Sportiv të bëhet kujdes sepse mendohet që aty pranë ka zonë arkeologjike (traseja e vjetër e rrugës Lissus-Najsus, një termë dhe një ujësjellës romak).**
3. **Miratohet:** Studim urbanistik dhe shesh ndërtimi për objektin “Fabrikë prodhimi, paketimi, tregtimi për objekte bujqësore”, fshati Pezë e Vogël.
4. **Miratohet:** Studim urbanistik pjesor në Lanabregas, Komuna Dajt.
5. **Miratohet:** Studim urbanistik dhe shesh ndërtimi për objektin “Fabrika e çimentos” në komunën Bushat.
6. **Miratohet:** Studim urbanistik i zonës me përparësi zhvillimin e turizmit Radhimë – Orikum. **me vërejtjen kujdes gjurmët e nekropoleve, kishat, që janë në afërsi të zonës së miratuar.**
7. **Miratohet:** Sheshi i ndërtimit për objektin “Hydrocentralet Lura 1, Lura 2, Lura3.
8. **Nuk miratohet:** Kërkesë për ndërtimin e një fabrike çimento në Zgërdhesh, Krujë.

III. Diskutimi i kërkesave për miratim projektesh nga institucione shtetërore:

1. **Miratohet:** Projekti i ndërtimit të ujësjellësit dhe shtrimit të rrugës me kalldrëm në kalanë e Elbasanit.
2. **Miratohet me shumicë votash:** Projekt përshtatje, Dega Berat e Bankës së Shqipërisë, Ambienti i shërbimit, lagja Mangalem, Berat.

IV. Diskutimi i projektit të financuar nga Qendra për ruajtjen dhe zhvillimin e Gjirokastrës

1. **Miratohet:** Projekt i restaurimit të galerive në kalanë e Gjirokastrës.

V. Do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme pika V e rendit të ditës: Diskutimi i projekteve të cilat presin financim:

1. Projekt idenë e rikonceptimit tërësor të mozaikut të Tiranës.
2. Projekti i restaurimit dhe rihabilitimit të kishës në Derven, Laç.
3. Projekti i restaurimit të Teqes së Sheh Dyrri, Tiranë.
4. Preventivi i punimeve për Teqenë e Frashërit, Gjirokastrë, relacion, preventiv. (Vazhdim)
5. Projekti i konsolidimit të pikturës murale në kishën Shën Mëria, Dhërmi.
7. Projekt restaurimi i banesës Lluka Goroi Pjetri, Berat.
9. Restaurimi i banesës së At Gjergj Fishtës, Lezhë.

VI. Diskutimi i kërkesave që duhen parë nga ana ligjore:

1. **Miratohet me shumicë votash**, kërkesa për rikonstuksion, Vila Dabërdaku, Shkodër. **Projekti miratohet me rikonstrukcion 2 kate, lartësi pothuaj e njëjtë me atë ekzistuesen, projekti duhet të trajtohet në të njëjtën linjë me ndërtesat përbri.**
2. **Miratohet** kërkesë për rikonstuksion banese me pronar Durim Nepravishtën, zona tampon, Berat.
3. **Nuk miratohet** kërkesë për leje rikonstrukcioni ish ambientet e Institutit të Arkeologjisë dhe palestrën sportive në zgjatim të saj, **(pritet plotësimi i dokumentacionit).**
4. **Miratohet:** Projekt i rikonstrukcionit të ish shkollës fillore në lagjen Kala.
5. **Nuk miratohet:** Projekt përshtatje e objektit Vasil Merdani (zonë tampon), Berat. **(Të verifikohet dokumentacioni)**
6. **Miratohet me shumicë votash:** Restaurim i banesës, pronar Halil Ymer Myderrizi, Durrës, **me vërejtjen të konsultohet projekti pranë IMK për mundësinë minimizimit të përdorimit të kollonave.**

VII. Diskutimi i kërkesave të qytetarëve për rikonstrukcione banesash me fonde private

1. **Miratohet:**Kërkesa për rikonstrukcion banese me pronar Demir Liçenji, Korçë.
2. **Miratohet:**Kërkesë për rikonstrukcion banese me pronar Sofokli Naçi, Korçë
3. **Miratohet:** Kërkesë për rikonstrukcion banese me pronar Nezir dhe Naxhie Hektori, Korçë, **me vërejtje, të hiqet ballkoni afër hyrjes.**
4. **Miratohet:** Kërkesë e Angjelina Prela për rikonstrukcion banese dy katëshe, qendra historike, Shkodër.
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi i banesës së Z. Lluka Gori Pjetri në lagjen Kala, Berat.
6. **Miratohet:** Restaurim banese 2 kate me pronar Celik Licenji, Korçë
7. **Miratohet:** Restaurim banese me pronar Vladimir dhe Vasil Seiti, lagja Palorto, Gjirokastrë
8. **Miratohet:** Restaurim banese me pronar Pranvera Zilfe, lagja Manalat II, Gjirokastrë.
9. **Miratohet:** Projekt rikonstrukcioni shtesë kati, banesa me pronar Z. Petrit Ngallopi lagja 28 nëntori, zona tampon Berat, **(Të përdoren kangjella druri)**
10. **Nuk miratohet:** Projekti i rikonstrukcionit të banesës Besnik Guri, Elbasan. (Projekti i miratuar në vitin 2002 nga Këshilli Shkencor). Të sillet i ripunuar projekti i çatisë së banesës dy katëshe, nuk miratohet rikonstrukcioni i banesës ngjitur, 1 kat)
11. **Miratohet:** Projekti ndërtim i ri i një klinike mjekësore (2 kate dhe podrum, rruga Koço Çamçe, me pronar Gaço Kane), Korçë, me vërejtjen të **ulet lartësia e objektit duke futur podrumin nën tokë.**
12. **Miratohet:** Restaurim banesa e Asllan Muhedinit, Gjirokastrë.
13. **Nuk miratohet:** Projekti i rikonstrukcionit të banesës së Ilia dhe Dion Tushi, Korçë.

14. **Miratohet: Projekti i restaurimit të ballit të godinës me ngjyrë të verdhë, i cili sheh nga rruga 13 Dhjetori, për kompleksin e familjes Bushati, Shkodër.**
15. **Miratohet rivënia në afat e projektit të rikonstruksionit të banesës me pronar Thanas Topia, lagja Goricë, Berat, miratuar me Vendim nr 2, dt. 24.11.2003, të KKR.**

Do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme:

1. Projekt-studim për rikonstruksionin e kompleksit të familjes Shkarpa, kala Berat.
2. Projekt restaurimi i banesës së Dhimitër Ikonomit, lagjia Goricë, Berat.
3. Kërkesë për rikonstruksion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan.
4. Kërkesë për ndërtim banese pranë lagjes kala, Elbasan. Fidelino Halo.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
ARDJAN TURKU**



**SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Valter Shtylla", is written over the printed name of the Secretary of the KKR.